



**QËNDRUESHMËRIA:**  
Për media pa urrejtje a dezinformim

---

# **KORNIZA RREGULLUESE DHE VETËRREGULLUESE KOMBËTARE KUNDËR GJUHËS SË URREJTJES DHE DEZINFORMIMIT**

**FLETË E FAKTEVE**

*Jeton Mehmeti*

**KOSOVË**

## QËNDRUESHMËRIA: për media pa urrejtje a dezinformim

Projekti rajonal QËNDRUESHMËRIA: Aksioni i shoqërisë civile për të riafirmuar lirinë e medias dhe luftën kundër dezinformimit dhe propagandës urryese në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi' zbatohet me mbështetjen e Bashkimit Evropian nga organizatat partnere [SEENPM](#), [Instituti Shqiptar i Medias](#), [Mediacentar Sarajevë](#), [Kosovo 2.0](#), [Instituti i Medias i Malit të Zi](#), [Instituti Maqedonas për Media](#), [Shkolla e Novi Sadit për Gazetari](#), [Instituti i Paqes](#) dhe [Bianet](#).

Info: <https://seenpm.org/>

Kontakttoni: [admin@seenpm.org](mailto:admin@seenpm.org)

## KORNIZA RREGULLUESE DHE VETËRREGULLUESE KOMBËTARE KUNDËR GJUHËS SË URREJTJES DHE DEZINFORMIMIT

### FLETË E FAKTEVE

#### KOSOVË

Autor: Jeton Mehmeti

Redaktore, studiuese kryesore rajonale: Brankica Petković

Redaktore e anglishtes: Fiona Thompson

Dizajni: Špela Kranjec për Filip Kranjec s.p., Lublanë, Slloveni

Botuesit: Kosovo 2.0, Prishtinë, SEENPM, Tiranë, dhe Instituti i Paqes, Lublanë

Prishtinë, tetor 2021

© Kosovo 2.0, SEENPM, Instituti i Paqes dhe autori



Ky botim është mundësuar me përkrahjen financiare të Bashkimit Evropian.  
Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit dhe e botuesve dhe  
nuk pasqyron medoemos pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

# PËRMBAJTJA

1. HYRJE 4

2. RREGULLIMI I GJUHËS SË URREJTJES 5

3. ZBATIMI I RREGULLORES SË  
GJUHËS SË URREJTJES 7

4. RREGULLIMI I DEZINFORMIMIT 9

5. PLATFORMAT PËR RAPORTIMIN E GJUHËS SË  
URREJTJES DHE DEMASKIMIN  
E DEZINFORMATAVE 11

5. REKOMANDIMET E POLITIKAVE 12

Literatura dhe burimet 13

Rreth autorit 13

## FLETË E FAKTEVE

# KORNIZA RREGULLUESE DHE VETËRREGULLUESE KOMBËTARE KUNDËR GJUHËS SË URREJTJES DHE DEZINFORMIMIT

*Jeton Mehmeti*

## 1. HYRJE

Liria e fjalës është e garantuar fuqishëm me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Megjithatë, duke pasur parasysh historinë e dhunshme politike të së kaluarës dhe përbërjen multietnike të shoqërisë së Kosovës, u krijuan një sërë dokumentesh ligjore për të vendosur disa kufij mbi lirinë e fjalës. Prandaj, shpifja, ofendimi dhe gjuha e urrejtjes u ndaluan të gjitha me ligje të veçanta.

Publikimi i një fakti a deklaratë të pavërtetë, kur botuesi e di ose duhet të dijë se fakti ose deklarata është e pavërtetë, e kuptimi ia dëmton reputacionin një personi tjetër (shpifje), ose një deklaratë, sjellje ose publikim i një deklaratë drejtuar një personi tjetër që është poshtëruar (fyerje) është i ndaluar me Ligjin Civil kundër shpifjes dhe fyerjes. Për më tej, kushdo që nxit a përhap publikisht urrejtje, mosmarrëveshje dhe intolerancë ndërmjet grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike dhe të tjera ose në bazë të orientimit seksual, të identitetit gjinor dhe karakteristikave të tjera personale, në një mënyrë që ka gjasa me prishë rendin publik, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet sipas Kodit Penal të Kosovës.

Veç kornizës ligjore, organet rregullatore të medias kanë zhvilluar më tej rregullore të brendshme për të kufizuar dhe ndëshkuar gjuhën e urrejtjes dhe dezinformimin. Kodi i Etikës i Komisionit të Pavarur për Media dhe Kodi i Mediave të Shkruara i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës përmbajnë udhëzime për raportim të drejtë dhe objektiv.

Pavarësisht kornizës së mirë ligjore, gjuha e urrejtjes është e pranishme nëpër kanalet e informimit në Kosovë. Një raport ex-officio i Avokatit të Popullit tregon se si dezinformimi dhe gjuha e urrejtjes mund të çojnë në dhunë ndaj një personi të synuar. Një numër vendimesh gjyqësore tregojnë se si qytetarët përdorin platformat mediatike për të nxitur urrejtje dhe paragjykime kundër një personi ose një grupi njerëzish bazuar në prejardhje etnike, fetare ose racore. Me ose pa dashje, mediat shpesh kanë publikuar materiale që

përmbajnë gjuhë nënçmuese, të ndaluar nga Kodi i Etikës, i vendosur nga organet rregullatore të medias. Për më shumë, organizatat e shoqërisë civile dhe platformat e kontrollit të fakteve ofrojnë dëshmi të përdorimit të gjuhës së urrejtjes në mediat e Kosovës kundër komuniteteve në Kosovë që janë më të ekspozuarat ndaj cenueshmërisë dhe diskriminimit verbal.

Ky hulumtim synon të analizojë kornizën rregulluese dhe vetërregulluese shtetërore kundër dezinformimit dhe gjuhës së urrejtjes. Ky është studimi i katërt kërkimor në serinë e projekteve Qëndrueshmëria.<sup>1</sup> Studimi i parë mbulonte modelet e medias së urrejtjes dhe të propagandës<sup>2</sup>, i dyti shqyrtonte narrativat e urrejtjes në media dhe komunikim në Kosovë<sup>3</sup>, dhe hulumtimi i tretë analizonte faktorët kryesorë që lidhen me besimin e mediave dhe çështjet mediatike-gjinore në Kosovë<sup>4</sup>.

## 2. RREGULLIMI I GJUHËS SË URREJTJES

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton lirinë e shprehjes sa kohë ajo nuk inkurajon dhunën dhe armiqësinë ndaj njerëzve të tjerë të bazuar në nacionalitet dhe fe. Neni 40 i Kushtetutës thotë:

*Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për t'u shprehur, për të shpërndarë dhe marrë informacion, mendime dhe mesazhe të tjera pa pengesë. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në rastet kur është e nevojshme të parandalohet nxitja ose provokimi i dhunës dhe armiqësisë në bazë të racës, kombësisë, etnisë ose fesë.<sup>5</sup>*

Megjithëse gjuha e urrejtjes nuk përmendet drejtpërdrejt në Kushtetutë, ajo është njëri nga elementët kryesorë të Kodit Penal. Neni 141 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i miratuar në janar 2019, rregullon gjuhën e urrejtjes që nxit përçarje dhe intolerancë.

*Kushdo që publikisht nxit ose përhap urrejtje, mosmarrëveshje dhe intolerancë ndërmjet grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike dhe të tjera ose në bazë të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave të tjera personale, në një mënyrë që mund të prishë rendin publik, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet.<sup>6</sup>*

1 "Qëndrueshmëria: veprimi i shoqërisë civile për të riafirmuar lirinë e medias dhe për të luftuar dezinformimin dhe propagandën e urrejtjes në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi" është projekt i financuar nga BE i zbatuar nga nëntë organizata të zhvillimit të medias.

2 <https://seenpm.org/research-hate-and-propaganda-in-kosovo-media/>

3 <https://seenpm.org/research-hate-narratives-in-online-media-and-communication-in-kosovo/>

4 <https://seenpm.org/research-mapping-citizens-concerns-over-media-in-kosovo/>

5 Neni 40, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>.

6 Neni 141, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf>.

Korniza ligjore është zgjeruar më tej me ligje specifike që lidhen me organet rregullatore të medias, si Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe akte të tjera nënligjore që rrjedhin prej tij. Njëri nga aktet nënligjore më të rëndësishme është Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Kosovë i miratuar në vitin 2016 nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM). Neni 5 i kushtohet nxitjes së urrejtjes:

*Ofruesit e Shërbimeve Mediatike (OShM) nuk duhet të inkurajojnë ose promovojnë, qëllimisht ose tërthorazi, asnjë formë diskriminimi dhe intolerance dhe nuk duhet të transmetojnë asnjë material që denigron një grup etnik ose fetar, ose që nënkupton se një grup etnik ose fetar është përgjegjës për veprimtari kriminale.*

*Raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose ndonjë opinion tjetër; origjina kombëtare ose sociale; shoqërimi me një komunitet; pronë; orientimi seksual, ekonomik dhe social; lindja, paaftësia a çdo status tjetër personal nuk duhet të përdoret në mënyrë të tillë që individët të jenë në pozitë të denigruar, të pafavorshme, të tallen a të përbuzen.*

*Gjatë transmetimit të përmbajtjes, OShM-të nuk do të lejojnë përdorimin e shprehjeve gjuhësore denigruese, që synojnë të dëmtojnë dhe kërcënojnë një individ ose një grup në bazë të përkatësisë etnike, fesë, gjinisë, racës, statusit martesor, moshës ose paaftësisë fizike a mendore.<sup>7</sup>*

Organi tjetër rregullator i mediave që monitoron gjuhën e urrejtjes është Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, një organ vetërregullues, anëtarët e të cilit janë mediat e shkruara dhe ato online. Njëri nga dokumentet kryesore të miratuara nga Këshilli i Shtypit është Kodi i Mediave të Shkruara. Neni 3 i Kodit flet për gjuhën e urrejtjes. Sipas tij: “Gazetat, mediat online dhe agjencitë e lajmeve nuk do të nxisin a promovojnë asnjë akt kriminal e të dhunshëm... (ato) nuk do të nxisin a përnxisin urrejtje apo pabarazi duke: trajtuar individin me paragjykime për shkak të prejardhjes etnike, fetare, gjinore, racore...”<sup>8</sup>

Përveç organeve rregullatore të medias, institucioni i Avokatit të Popullit ofron udhëzime që rregullojnë gjuhën e urrejtjes. Misioni i tij është të promovojë të drejtat e lirisë, duke përfshi mbrojtjen nga gjuha e urrejtjes.

<sup>7</sup> Neni 5, Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, KPM, <https://www.kpm-ks.org/en/legjislacioni/299/aktet-nenligjore-ne-fuqi/299>.

<sup>8</sup> [http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2019/11/Kodi-i-Mediave-te-CC%88-Shkruara-te-CC%88-Kosove-CC%88s\\_2019.pdf](http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2019/11/Kodi-i-Mediave-te-CC%88-Shkruara-te-CC%88-Kosove-CC%88s_2019.pdf)

### 3. ZBATIMI I RREGULLORES SË GJUHËS SË URREJTJES

**Prokurorët dhe gjykatat** janë ndër organet kryesore ligjore që merren me rastet e gjuhës së urrejtjes. Qytetarët dhe organizatat kanë adresuar rastet e veta në gjykatë për çështjet e gjuhës së urrejtjes. Për shembull, në gusht të vitit 2021, Gjykata Themelore në Prizren shpalli fajtor një qytetar për shkak të nxitjes së urrejtjes ndaj komunitetit musliman në Prizren përmes postimeve dhe fotografive në Facebook, si dhe për shkak të komenteve të bëra nga të tjerët në postimet e tij në Facebook, që po ashtu përmbajnë gjuhë të urrejtjes. Gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi një gjobë prej 400 eurosh.<sup>9</sup>

Mbi të njëjtën bazë, për shkelje të nenit 141 të Kodit Penal, një muaj më vonë, një tjetër shtetas në Gjakovë u shpall fajtor për botim të librit dhe organizim të një ngjarjeje promovuese ku autori lexoi disa nga përmbajtjet e librit që përmbajnë poezi të cilat nxisin urrejtje ndaj grupeve fetare të ndryshme në Kosovë. Gjyqtari e dënoi personin me masën e paraburgimit prej 150 ditësh, i cili më pas iu zëvendësua me 2000 euro gjobë.<sup>10</sup>

Një nga rastet e profilit të lartë lidhur me shkeljen e nenit 141 të Kodit Penal lidhet me një ish-ministër i cili u shpall fajtor për gjuhën e tij të urrejtjes në një tubim publik në vitin 2019, ku ai e quajti 'trillim' masakrën e Reçakut. Gjyqtari e dënoi me burgim prej dy vjet e gjysmë.<sup>11</sup>

Përveç prokurorëve dhe gjykatave, **edhe organet rregullatore të medias** janë marrë me raste që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes. Janë dy organe kryesore që shërbejnë si adresë për ankesat e qytetarëve lidhur me dezinformimin dhe gjuhën e urrejtjes, përkatësisht Komisioni i Pavarur për Media (KPM) dhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSH).

KPM-ja është organ kushtetues, misioni i të cilit është licencimi i mediave transmetuese në Kosovë. Duke pasur parasysh autoritetin ligjor, KPM-ja ka të drejtë të shqiptojë gjoba dhe t'ua heqë licencat stacioneve televizive, radiostacioneve dhe ofruesve kabllorë në rast se ata nuk respektojnë standardet e tij të transmetimit. Nxitja e urrejtjes ndalohet me Kodin e Etikës të zbatuar nga KPM. Sipas kësaj rregulloreje, ofruesit e shërbimeve mediatike të licencuar nga KPM-ja nuk duhet të transmetojnë përmbajtje programore që nxisin urrejtje dhe pabarazi dhe që mund të rezultojnë në veprime kriminale ose të dhunshme kundër një individi a grupi. Më tej, neni ndalon mediat të transmetojnë përmbajtje programore që nxisin urrejtje në bazë të përkatësisë etnike, fesë, gjinisë, racës, statusit martesor, orientimit seksual, moshës dhe paaftësisë mendore a fizike.<sup>12</sup>

9 [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/PZ\\_P\\_160\\_20\\_SQ.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/PZ_P_160_20_SQ.pdf)

10 [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/GJK\\_P\\_2021-192904\\_SQ.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/GJK_P_2021-192904_SQ.pdf)

11 [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/PR\\_PKR\\_20\\_19\\_SQ.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/PR_PKR_20_19_SQ.pdf)

12 Komisioni i Pavarur për Media, Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale, 2016

Ka disa raste kur KPM-ja ka konstatuar shkelje të Kodit, përfshi nenin 5 për nxitjen e urrejtjes. Në një rast të vitit 2017, KPM-ja ka konstatuar se RTK 1 (televizioni publik) ka shkelur Kodin e Etikës, kur në njërin nga emisionet ka përmendë emrat e disa qytetarëve serbë dhe i ka quajtur spiunë rusë. Në ankesën e Unionit të Gazetarëve Serbë sugjerohet se një gjuhë e tillë mund të çojë në tensione ndëretnike.<sup>13</sup>

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, në anën tjetër, merret me ankesat lidhur me shkeljet e Kodit të Etikës për Mediat e Shkruara. Mes shumë ankesave ku Këshilli i Mediave të Shtypura konstatoi shkelje, janë ato që kanë shkelur nenin 3 të Kodit, i cili ndalon nxitjen e urrejtjes. Në rastin Gramos Agusholli kundër Express dhe Infokus, ku të dy mediat publikuan një artikull me titullin “Deputetët islamikë të LVV-së bëjnë një vizitë te Khalifi”, Këshilli i Mediave të Shkruara konstatoi se artikulli i publikuar në korrik 2021 përmban elemente nxitëse të urrejtjes dhe shkel nenin 3 të Kodit të Etikës.<sup>14</sup>

Në një rast tjetër, shkeljen e nenit 3 e ka bërë Gazeta Metro e cila publikoi një artikull me elemente të paragjyimit dhe urrejtjes racore. Shkrimi i titulluar “Kung-fuja i Kurtit u kthye në Prishtinë”, flet për një shtetas kinezo-amerikan që ka shërbyer si këshilltar i kryeministrit të Kosovës. Artikulli përmban një foto të Tienmu Ma të ulur në një kafene. Në vendimin e Këshillit të Mediave të Shtypura të marrë në shtator 2021 thuhet se artikulli ka shkelur Kodin e Etikës duke nxitur urrejtje të bazuar në elemente racore.<sup>15</sup>

Përveç gjuhës që nxit urrejtjen racore, Këshilli i Mediave të Shtypura ka konstatuar shkelje të lidhura me paragjykimet gjinore. Në një shkrim, portali online Gazeta Express ka shkruar: “Përkundër numrit 69, Besa Luzha nuk është votuar as nga bashkëshorti i saj”. Në ankesë thuhet se artikulli përmban dezinformata dhe nxitje të urrejtjes në bazë të gjinisë. Këshilli i Mediave të Shtypura vendosi në nëntor 2019 se gazeta kishte shkelur nenin 2 të Kodit të Etikës duke publikuar informacione të rreme lidhur me atë se kush votoi për zonjën Luzha si dhe nenin 3 të Kodit të Etikës duke përdorë gjuhë nënçmuese dhe seksiste. Duke përdorë domethënien seksuale të numrit 69, mediat synuan ta dëmtonin qëllimisht atë dhe familjen e saj.<sup>16</sup>

Një institucion tjetër që merret me gjuhën e urrejtjes dhe të drejtat e njeriut është ai i Avokatit të Popullit të Kosovës . Një nga rastet më spektakolare që çoi nga gjuha e urrejtjes në dhunë ndodhi në vitin 2019 kur mediat elektronike dhe ato online publikuan informacione për një grua që dyshohej se po rrëmbente fëmijë në rrugë. Asokohe, mediat online publikuan një fotografi të një gruaje të ulur në stacionin e autobusëve në Malishevë me titullin “Kujdes, kjo grua po rrëmben fëmijë”. Pasi lajmi u bë viral në mediat online dhe rrjetet sociale, gruaja u rrah nga një grup të rinjsh në një sulm që u regjistrua me celular dhe u bë edhe viral.<sup>17</sup>

13 <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Publikime/Dokumente/1545987337.8987.pdf>

14 [http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2021/10/vendim\\_KMSHK\\_1168-2021.pdf](http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2021/10/vendim_KMSHK_1168-2021.pdf)

15 [http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2021/10/vendim\\_KMSHK\\_1180-2021.pdf](http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2021/10/vendim_KMSHK_1180-2021.pdf)

16 [http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2019/11/vendim\\_KMSHK\\_852-2019.pdf](http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2019/11/vendim_KMSHK_852-2019.pdf)

17 <https://indeksonline.net/goditet-ne-lipjan-gruaja-e-dyshimte-qe-u-be-e-famshme-ne-rrjetet-sociale/>



Institucioni i Avokatit të Popullit në një raport sipas detyrës zyrtare konstatoi shkelje të shumta të të drejtave të njeriut në këtë rast,<sup>18</sup> duke përfshirë shkeljen e Kodit të Etikës të KPM-së si dhe të nenit 202 të Kodit Penal për fotografimin e paautorizuar dhe regjistrimin tjetër, ku thuhet:

*Kushdo që, pa autorizim, fotografon, filmon ose në ndonjë mënyrë tjetër regjistron një person tjetër në ambientet e veta personale ose në ndonjë vend tjetër ku personi ka pritshmëri të arsyeshme të privatësisë, dhe kështu cenon thelbësisht privatësinë e tjetrit, duhet të dënohet me gjobë ose me burgim nga një deri në tre vjet.<sup>19</sup>*

## 4. RREGULLIMI I DEZINFORMIMIT

Në sistemet komplekse të sotme të informacionit, është e rëndësishme të kuptohet terminologjia e përdorur për informacionin dhe gjuhën e urrejtjes. Si fillim, keqinformimi dhe dezinformimi shpesh përdoren gabimisht ndërsjellazi. Ndonëse të dyja paraqesin rreziqe të caktuara për të drejtat dhe shoqërinë tonë, ndryshimi midis të dyjave është te qëllimi. Keqinformimi është informacion mashtrues, i pasaktë ose krejt i rremë që komunikohet pa qëllimin e qartë për të mashtruar. Megjithatë, synohet të perceptohet si informacion serioz dhe faktik nga audienca. Dezinformimi është informacion i rremë që shpërndahet me qëllim të mashtrimit të njerëzve. Shpërndarësi i “lajmit” e din se ai është i rremë dhe dëshiron të mashtrtojë audiencën e tij. Ndryshe nga keqinformimi, qëllimi i dezinformimit nuk është një përpjekje e sigurtë për të ndriçuar, por përpjekje keqdashëse për të krijuar ndarje dhe për të nxitur frikë.<sup>20</sup> Një studim i Parlamentit Evropian i referohet dezinformimit si “informacion i rremë, i pasaktë ose mashtrues, i krijuar, i paraqitur dhe i promovuar qëllimisht për të shkaktuar dëm publik ose për të përfitur”.<sup>21</sup> Ai paralajmëron se dezinformimi mund të ngatërrojë dhe manipulojë qytetarët; të krijojë mosbesim në normat ndërkombëtare, institucionet apo strategjitë e miratuara në mënyrë demokratike; t’i prishë zgjedhjet; ose të ushqejë mosbesimin ndaj sfidave kyç si ndryshimi i klimës.

Sipas përkufizimit të IREX, **informacioni** përfshin çdo material të përdorur për të komunikuar njohuri ose fakte, si artikuj gazetash ose revistash, transmetime radioje ose televizive, podkaste, blogje ose postime në media sociale. Ai përfshin çdo informacion të disponueshëm brenda vendit, pavarësisht nëse është prodhuar në vend. **Dezinformata**, siç përcaktohet nga IREX, është informacion që nuk është faktik. Ai përfshin informacione të rreme ose të pasakta që krijohen me qëllim të mashtrimit ose shpërndhjes (dmth. dezinformimit), si dhe informacione të rreme që krijohen ose përhapen pa vetëdije. Një kategori tjetër informacioni, e përcaktuar nga IREX, është

18 <https://www.oik-rks.org/wp-content/uploads/2019/12/Ex-Officio-Raporti-me-rekomandime-468-2019-compressed.pdf>

19 Neni 202, Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

20 <https://www.liberties.eu/en/stories/misinformation-vs-disinformation/43752>

21 [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2021/653635/EXPO\\_STU\(2021\)653635\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2021/653635/EXPO_STU(2021)653635_EN.pdf)

**keqinformimi**, informimi që bazohet në fakt, por përdoret qëllimisht dhe me dashakeqësisht për të dëmtuar individë, organizata ose grupe njerëzish. Së fundi, **përkufizimi i gjuhës** së urrejtjes i përdorur nga IREX është përdorimi i gjuhës për të kryer sulme të drejtpërdrejta kundër një individi ose një grupi njerëzish, bazuar në një sërë karakteristikash të mbrojtura, si raca, etnia, kombësia, feja, seksi, orientimi seksual, identiteti gjinor dhe aftësia fizike ose mendore. Të dyja janë krijuar me qëllim për të dëmtuar individët, grupet e njerëzve ose interesin publik.<sup>22</sup>

Përkundër avancimit të terminologjisë, korniza ligjore e Kosovës për dezinformimin është mjaft e përgjithshme. Megjithatë, ekzistojnë disa dokumente ligjore që tentojnë të rregullojnë dezinformimin në Kosovë.

Fillimisht, Ligji kundër shpifjes dhe fyerjes, i miratuar në vitin 2008, duke garantuar të drejtën e lirisë së shprehjes, vendos disa standarde për kompensimin e personave, reputacioni i të cilëve cenohet nga shpifja dhe fyerja. Sipas ligjit, shpifje nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë që botuesi e di ose duhet ta dijë se është e pavërtetë, kuptimi i të cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër, ndërsa fyerja nënkupton një deklaratë, sjellje ose publikim të një deklarate drejtuar një personi tjetër që është poshtëruese. Për më tej, publikim nënkupton përhapjen e një shprehjeje, qoftë në formë të shkruar apo të folur, qoftë në mediane e shkruar apo elektronike ose me mjete të tjera, e cila dëgjohet apo lexohet nga të paktën një person i tretë.<sup>23</sup> Sipas të njëjtit ligj, një person ka të drejtë të kërkojë të ndalojë shpifjen dhe fyerjen dhe të kërkojë që ajo të mos përsëritet në të ardhmen, ose përgënjeshttrimin e informacionit shpifës ose fyes dhe kompensimin për dëmin moral dhe material të shkaktuar nga shpifja dhe fyerja, përmes një procesi gjyqësor. Për më shumë, Ligji pohon se nëse shpifja dhe fyerja kryhen përmes një mas-mediumi, ajo duhet të përgënjeshtrohet në të njëjtin mas-medium dhe do t'i jepet e njëjta rëndësi. Përgënjeshtrimi do të botohet brenda tetë ditëve nga marrja e kërkesës përkatëse në rastin e gazetave të përditshme, në të njëjtën faqe ku janë botuar shpifja dhe fyerja, në numrin e ardhshëm të një gazete periodike ose të një agjencie telegrafike dhe brenda tetë ditësh në të njëjtën mënyrë ose në të njëjtën orë të ditës në rast të transmetimit të informacionit.<sup>24</sup>

Veç kësaj, Kodi i Etikës i KPM-së ofron udhëzime të mëtejshme kur bëhet fjalë për saktësinë e lajmeve të publikuara nga anëtarët e saj. Neni 6 i Kodit të Etikës pohon se

*Ofruesit e Shërbimeve mediatike (OShM) duhet të raportojnë lajmin me saktësi dhe ta prezantojnë atë në mënyrë të paanshme. Ata nuk duhet të transmetojnë materiale që e dinë ose duhet të dinë se janë të rreme ose mashtruese... OShM-të kanë detyrimin profesional të korrigjojnë menjëherë çdo informacion të publikuar që rezulton i pasaktë dhe ta pranojnë gabimin e tyre. Korrigjimet duhet të planifikohen siç duhet.*<sup>25</sup>

<sup>22</sup> Barometri i gjallë i informacionit, IREX.

<sup>23</sup> Ligji kundër shpifjes dhe fyerjes, Nr.02/L-65

<sup>24</sup> Ibid.

<sup>25</sup> Komisioni i Pavarur për Media, Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale, 2016

Sipas standardeve të KPM-së, ndonëse OShM-të janë të lirë të shprehin mendimet e tyre, ata duhet të bëjnë një dallim të qartë ndërmjet lajmit dhe opinionit. Lajmi është informacion i përbërë nga fakte dhe të dhëna, ndërsa opinionit mbart mendime, ide, besime, supozime, komente ose gjykime me vlerë. Megjithatë, në shumë vendime disiplinore të KPM-së dhe Këshillit të Mediave të Shkruara, disa media dështojnë të bëjnë dallim të qartë ndërmjet lajmit dhe opinionit, qoftë me dashje ose jo. Edhe Këshilli i Mediave të Shkruara trajton saktësinë e raportimit në Kodin e tij të Mediave të Shkruara. Neni 2 i Kodit thotë: “Reporterët dhe redaktorët në punën e tyre duhet të respektojnë të vërtetën faktike dhe të drejtën e publikut për të ditur të vërtetën”.<sup>26</sup>

## 5. PLATFORMAT PËR RAPORTIMIN E GJUHËS SË URREJTJES DHE DEMASKIMIN E DEZINFORMATAVE

Përveç kornizës ligjore që garanton lirinë e fjalës duke i mbrojtur qytetarët nga gjuha e urrejtjes dhe dezinformimi, Kosova ka organe institucionale dhe vetërregulluese që merren me gjuhën e urrejtjes. Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut ofron një platformë legislative për rregullimin e gjuhës së urrejtjes. Ky komision punon ngushtë me Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës, i cili është një tjetër platformë e rëndësishme për adresimin e gjuhës së urrejtjes dhe shkeljes së të drejtave të njeriut. Në një nivel më të ulët, qytetarët e Kosovës përdorin Gjykatat Themelore si platformë për të kërkuar drejtësi kur janë në shënjestër të gjuhës së urrejtjes. Për më tej, edhe Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme janë marrë me raste që përfshijnë gjuhën e urrejtjes. Vendimi dhe interpretimi në lidhje me gjuhën e urrejtjes janë dhënë edhe nga organet rregullatore të mediave, si Komisioni i Pavarur për Media dhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, të cilët merren çdo muaj me ankesat kundër ofruesve të shërbimeve mediatike për çështje që kanë të bëjnë me shkeljen e standardeve të gazetarisë, duke përfshirë nxitjen e urrejtjes.

Organizatrat e shoqërisë civile (OSHC) në Kosovë ofrojnë një tjetër platformë për raportimin e gjuhës së urrejtjes dhe dezinformimit. Kontributi i OShC-ve lokale në frenimin e gjuhës së urrejtjes dhe luftimin e dezinformimit vjen në formën e hulumtimit dhe publikimit ose në formën e avokimit. Një projekt i quajtur “Luftimi i urrejtjes në Kosovë”, i cili u zbatua nga dy OShC vendase, ATRC dhe RADC, publikoi një varg raportesh në lidhje me përdorimin e gjuhës së urrejtjes në mediat e Kosovës kundër komuniteteve në Kosovë të cilat janë më të ekspozuara ndaj cënueshmërisë dhe diskriminimit verbal.<sup>27</sup>

Internews Kosova është një tjetër organizatë që ka krijuar një platformë për verifikimin e fakteve që synon të demaskojë lajmet e rreme. Që nga viti 2016, kjo organizatë ka zbatuar një projekt të quajtur “Krypometer” që specializohet në verifikimin e fakteve të pretendimeve publike dhe raportimin e medias.<sup>28</sup>

<sup>26</sup> Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, Kodi i Mediave të Shkruara, 2019

<sup>27</sup> ATRC, “Hate-o-meter”, 2021, <https://advocacy-center.org/wp-content/uploads/2021/06/Hate-0-Meter-Research.pdf>.

<sup>28</sup> <https://kallxo.com/krypometer/>

Një ekip i posaçëm gazetarësh angazhohet për çdo javë që të identifikojë pretendimet që duken të rreme ose mashtruese dhe më pas të sigurojë prova që minojnë pretendimet e tilla. Në një kohë kur dezinformimet, keqinformimet dhe lajmet e rreme janë në rritje, kjo platformë duket se kontribuon në identifikimin e informacioneve të rreme që përndryshe do të mashtronin qytetarët e Kosovës.

Së fundi, Veprimi për Shoqërinë Demokratike (VShD) është një tjetër OShC e specializuar në demaskimin e dezinformatave. VShD drejton një projekt specifik për kontrollin e fakteve të quajtur "hybrid.info", i cili jo veç ofron analiza të bazuara në prova të lajmeve të rreme, por identifikon edhe mediat e dyshimta të rreme në gjuhën lokale. Në Kosovë ka edhe OShC të tjera që drejtojnë projekte afatshkurtra që synojnë rritjen e edukimit mediatic në Kosovë.

## 5. REKOMANDIMET E POLITIKAVE

- Lidhur me diturinë mbi mediat dhe informacionin, Qeveria e Kosovës dhe institucionet përkatëse arsimore, si Ministria e Arsimit, duhet urgjentisht të prezantojnë lëndë që do të mësohen në shkollë për të ofruar të kuptuar më të mirë të mediave dhe të informacionit.
- Institucionet arsimore të Kosovës duhet të shtojnë mësimdhënien e të menduarit kritik dhe sferës online për të përmirësuar gjuhën përndezëse dhe fyerjet e papërshtatshme etnike online.
- Organet e vetërregullimit duhet të mbajnë diskutime me anëtarët dhe t'i nxisin që të marrin masa në seksionet e komenteve të mediave online, mediave sociale dhe rrjeteve, kur ato të shfaqen.
- Organizatat e mediave duhet t'i shtojnë mekanizmat e kontrollit të fakteve / redaksitë dhe t'ua kujtojnë gazetarëve më shpesh Kodin e Etikës.
- Media duhet të ketë seanca të rregullta me gazetarë për të diskutuar gjuhën e urrejtjes, gjuhën e papërshtatshme dhe fyerjet etnike në mënyrë që t'i parandalojë në përmbajtje, komente dhe komunikime të tjera.
- Media duhet të bashkëpunojë më shumë me institucionet e kontrollit të fakteve dhe organizatat joqeveritare në luftën kundër gjuhës së urrejtjes.
- Media duhet të krijojë koalicione anti-urrejtje e anti-propagandë për të luftuar gjuhën përndezëse në komunikimin politik.
- Të rritet bashkëpunimi i OShC-ve dhe seksionit të verifikimit të fakteve të OShC-ve dhe mediave me rrjetet sociale globale për të raportuar/lajmëruar gjuhën e urrejtjes dhe dezinformimin në gjuhën lokale, në mënyrë që të kontribuohet në heqjen e përmbajtjeve të tilla nga rrjetet.

## Literatura dhe burimet

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kodi Penal i Republikës së Kosovës

Ligji kundër shpifjes dhe fyerjes, Nr.02/L-65

Komisioni i Pavarur për Media, Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale, 2016

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, Kodi i Mediave të Shkruara, 2019

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Aktgjykime 2019–2021

Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës, Raportet Vjetore 2017–2020 dhe Raportet ex-Officio 2017-2021

ATRC, “Hate-o-meter”, 2021

The European Parliament, “The Impact of Disinformation on democratic processes and human rights in the World”, 2021

Civil Liberties Union for Europe, “Misinformation vs. Disinformation”, 2021

IREX, “Vibrant Information Barometer”, 2021

Kallxo.com. “Krypometer”, 2021

ADC, “hibrid.info”, 2021

## Rreth autorit

Jeton Mehmeti është profesionist i medias, konsulent dhe ekspert hulumtues me më shumë se një dekadë përvojë në mbështetjen e biznesit mediatik, ideve inovative të medias dhe vlerësimit të kapaciteteve mediatike. Ai ka punuar me organizata të shumta mediatike në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke i mbështetë ato në planifikimin strategjik, transformimin e menaxhimit dhe ndërtimin e komunitetit.

Ky publikim është pjesë e komponentit të hulumtimit të projektit QËNDRUESHMËRIA. Ai përfshin një seri fletësh të të dhënave mbi KORNIZA RREGULLUESE DHE VETËRREGULLUESE KOMBËTARE KUNDËR GJUHËS SË URREJTJES DHE DEZINFORMIMIT në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Turqi. Seria përfshin gjithashtu një fletë të të dhënave me shembuj të mekanizmave rregullues dhe vetërregullues në nivel të BE-së dhe në shtetet anëtare të BE-së.

Nëntë organizata të zhvillimit të medias në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi kanë bashkuar forcat në kuadër të një projekti të financuar nga BE “QËNDRUESHMËRIA: Veprim i shoqërisë civile për të riafirmuar lirinë e medias dhe për të luftuar dezinformimin dhe propagandën e urrejtjes në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi”. Projekti trevjeçar koordinohet nga Rrjeti i Evropës Juglindore për Profesionalizimin e Medias (SEENPM), një rrjet organizatash për zhvillimin e medias në Evropën Qendrore dhe Juglindore, dhe zbatohet në partneritet me: Institutin Shqiptar të Medias në Tiranë, Fondacionin Mediacentar Sarajevë, Kosova 2.0 në Prishtinë, Institutin e Medias së Malit të Zi në Podgoricë, Institutin Maqedonas për Media në Shkup, Shkollën e Gazetarisë Novi Sad në Novi Sad, Institutin e Paqes në Lublanë dhe Bianet në Stamboll.